



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2021:069246
Datë: 28.05.2024
Numri i dokumentit: 05747146

C.nr.201/21

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtarja Hatixhe Begaj, me zyrtaren ligjore Albanë Morina, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N.G.nga fshati Ç., Komuna e K., tani me vendbanim ne K., rruga” D. e K.”, i punësuar ne SHMP “L.P.”, në fshatin ., Komuna e Malishevës, të cilin e përfaqëson avokati Agron Kryeziu, nga Malisheva, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i udhëtimit vlera e objektit të kontestit 901.6 euro, jashtë seancës, më datën 28.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadija e paditësit .G.nga fshati Ç., Komuna e K., tani me vendbanim ne K., rruga” D. e K.”, i punësuar ne SHMP “L.P.”, në fshatin ., Komuna e Malishevës ashtu që **OBLIGOHET** e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, në emër të kompensimit për udhëtim në punë për periudhën kohore prej datës 18.04.2017 e deri më datën 21.11.2022, për 644 ditë, paditësit N. G. **të i’ a paguajë shumën e përgjithshme prej 901.60 euro**, duke e llogaritur nga 70% e biletës se udhëtimit në shumën prej 2 euro për 644 ditë të vajtjes në punë në relacionin K.– në fshatin K., Komuna e Malishevës, dhe anasjelltas me kamatë ligjore 8% nga dita e paraqitjes se padisë dt.06.04.2021, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 125.00 euro, ndërsa REFUZOHET pjesa tjetër e shpenzimeve të procedurës mbi shumën e aprovuar konkretisht në shumën prej 104.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi .G.nga fshati Ç., Komuna e K., tani me vendbanim ne K., rruga” D. e K.”, i punësuar ne SHMP “L.P.”, në fshatin ., Komuna e Malishevës i përfaqësuar nga av.Agron Kryeziu, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi me dt.06.04.2021, kundër të paditurës Komuna e Malishevës - Drejtoria Komunale për Arsim, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit.

Me dt.16.02.2023, paditësi përmes të autorizuarit të tij av. Agron Kryeziu, ka bërë precizimin e kërkesëpadiisë, duke theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës në SHMP “ Lasgush Pogradeci”, në K., dhe vazhdon të punoj, e që duke llogaritur periudhën kohore prej datës

18.04.2017 deri me datën 21.11.2022, gjithsej janë 644 ditë punë të përlogaritur sipas udhëtimit ditor në relacionin Klinë – në fshatin Kijeve, Komuna e Malishevës, dhe bileta e udhëtimit ditor 1€, dhe Kijeve – Klinë, bileta 1€, në ditë të punës në bazë të biletave të udhëtimit gjithsej 2€,- 30%=1.40€, 644x 1.40=901.6€, ta paguaj shumën e përgjithshme prej 901.6€, që dëshmohet me vërtetimet e shkollës SHMP "Lasgush Pogradeci" në Kijeve, Nr. prot.05/22 i datës 12.01.2023, dhe biletat e kompanisë se autobusëve N.T.P "Niku Tours", si dhe kuponit fiskal dhe Kontrata mbi qiranë ku banon paditësi, të gjitha këto më kamat ligjore prej 8% prej ditës së paraqitje së padisë dhe atë për përpilimin e padisë shumën prej 104€, për precizimin e padisë shumën prej 104 €, si dh e taksat gjyqësore shumën prej 21€, të gjitha këto në afat prej 15 ditë nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit më dhunë.

E paditura përmes përgjigjes së saj në padi ndër të tjera ka theksuar se e kundërshton në tersi padinë dhe kërkesëpadinë, për pagesën e udhëtimit sipas kontratës kolektive të viti 2017, pasi që kjo padi është në kundërshtim kontrata kolektive për faktin se paditësi nuk ka ofruar prova se nga cili relacion udhëton dhe në çfarë kohe, por ka ofruar dy bileta të autobusit për gjithë paditësin. Po ashtu padia është paraqitur jashtë afatit ligjor pra është paraqitur pasi kontrata kolektive e arsimit e vitit 2017 ka skaduar më datën 18.04.2020, ndërsa padia është paraqitur në vitin 2021, po ashtu nuk është vërtetuar gjendja faktike lidhur më llogaritjen e ditëve të punës për paditësin për vitin 2020, pasi që në bazë të kalendarit të vitit shkollor 2020-2021, ditët e mësimi është dashur të hiqet koha e pandemisë që ka filluar nga data 12.03.2020 e deri në përfundim të vitit shkollor me datën 30.06.2020, për muajin mars 20 ditë, për muajin prill 18 ditë, për muajin maj 18 ditë, si dhe për muajin qershor 21 ditë, duke marrë parasysh që deri me datën 12 mars është mbajtur mësim, është dashur të zbriten 67 ditë në total për paditësin. Po ashtu paditësi nuk ka ofruar argumente dhe prova gjithë kuponat fiskal të biletave udhëtimit kohën kur paditësi ka udhëtuar për në punë e jo vetëm të ofrohet kupona blanko dhe në bazë të supozimeve. Komuna e Malishevës e konteston vlerën e borxhit lidhur me këtë çështje, pasi që kontrata kolektive e arsimit e lidhur në mes të SBASHK dhe MASHT është shkëputur nga MASHT dhe kjo kontratë kolektive tani nuk është në fuqi pasi që palët të cilët e kanë nënshkruar këtë kontratë nuk kanë pasur legjitimitet që ta nënshkruajnë këtë kontratë dhe i ka munguar baza ligjore për nënshkrimin e saj, e gjithë kjo bazuar në njoftimin që ka bërë MASHT për SBASHK me datën 21.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate, po ashtu MAPL ka bërë njoftim për kryetaret e Komunave me datën 22.11.2022, për shkëputjen e kësaj kontrate nga MASHT për mungesë të bazës ligjore të kësaj kontrate kolektive, kjo kontratë tani nuk është në fuqi, pasi është shkëputur nga MASHT dhe ka qenë e lidhur nga kjo Ministri, Komuna e Malishevës – DKA, e lidhur me këtë çështje kontestuese nuk kanë legjitimitet të palës aktive në këtë procedurë, por këtë legjitimitet tani e ka MASHT, i propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë Dega Malishevë që ta refuzon padinë e paditësve si të pa bazuar ose kjo çështje kontestuese të zhvillohet ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës – MASHT.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura në punë në shkollën e Mesme Profesionale "Lasgush Pogradeci" në K..

Kjo vërtetohet nga kontrata e punës dhe nga Vërtetimi për përvojën e punës në emër të paditësit të lëshuara nga e paditura me nr.prot.... me datë 12.01.2023.

Nga vërtetimet mbi ditët e prezencës në punë: nr.prot.05/22, të datës 12.01.2023, të lëshuar nga IAAP “Lasgush Pogradeci” në Kijevë, të cilëve gjykata ua dha besimin e plotë, nga të cilët ka vërtetuar faktin se paditësi kanë themeluar marrëdhënie pune në pozitën mësimdhënëse në IAAP “Lasgush Pogradeci” në Kijevë dhe për periudhën nga data 18.04.2017 e deri me datën 31.08.2021 paditësi N. G., ka gjithsej 644 ditë pune.

Me shikimin dhe analizimin e certifikatës së vendbanimit nr.ser.B... të lëshuar me datën 19.04.2024 nga Zyra e Gjendjes Civile Carrallukë, Malishevë dhe biletat e udhëtimit të lëshuar nga kompania e autobusëve N.SH.T “Niki Tours”, (të cilëve gjykata ua dha besimin e plotë), vërtetohet se paditësi N. G., ka vendbanimin në Klinë, dhe për të shkuar në vendin e punës duhet të udhëtoj në relacionin Klinë - Kijevë dhe anasjelltas, si dhe ta paguaj biletën e udhëtimit në shumën prej 1.00 euro në një drejtim, e shumën prej 2 euro në të dy drejtimet.

Ligji Nr.03/L-212 i Punës, neni 90 par. 4 dhe 5 përcaktojnë se: *“4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet.”* dhe *“5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive.”*

Neni 35 par. 5 i Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë Nr.01B-2056 të datës 18.04.2017 dhe asaj Nr.01/B-105 të datës 22.01.2021, përcakton që: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”.*

Pra, në pajtueshmëri me dispozitën ligjore të lartcekur është paraparë detyrimi i punëdhënësit, në rastin konkret të paditurës, për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, për shkak se Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret, e paditura është punëdhënëse e paditësve dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim.

Andaj, gjykata e aprovoi në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit lidhur me kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën Komuna e Malishevës – Drejtoria Komunale për Arsim, që paditësit N. G., për periudhën prej datës 18.04.2017 e deri më datën 31.08.2021, në emër të kompensimit të shpenzimeve të udhëtimit për 644 ditë t’ia paguaj shumën prej 901.6 euro (644 ditë pune x 1.40 euro biletë x 70% = 901.6 Euro) për 644 ditë të vajtjes në punë në relacionin Klinë- Kijevë, dhe anasjelltas.

Gjykata me rastin e vendosjes (jashtë seancës gjyqësore) është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë e përcakton se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”.*

Bazuar në dispozitat e Nenit 398 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret,

kërkesëpadia e paditësve ishte qartazi e themeltë, si e tillë ka bazë në dispozitat e Kontratës Kolektive të përmendur më lartë, ndërsa shuma e kompensimit bazohet në provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës në përgjigje në padi gjykata vlerëson se të njëjtat janë të pabazuara dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike me të cilën do të duhej të refuzohej kërkesëpadia e paditësit. Pretendimet e të paditurës se i mungon legjitimiteti pasiv në procedurë janë të pabazuara, me arsyetimin se Kontratën Kolektive të Arsimit e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, e njëjta prodhon efekt juridik ndaj punëdhënësve të cilët kanë të punësuar punëtorë që të drejtat e tyre burojnë nga kjo kontratë. Në rastin konkret e paditura është punëdhënëse e paditësve (mësimdhënësve) dhe detyrohet për përmbushjen e detyrimeve që dalin nga kjo kontratë në raport me të punësuarit e saj në arsim.

Pretendimet e të paditurës se Kontrata Kolektive është shkëputur dhe nuk prodhon efekt juridik nuk kanë mbështetje ligjore, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase sipas Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme nr 214/2023, Kontrata kolektive e vitit 2017 ka pasur efekt deri më 21.01.2021, dhe paditësi kërkesëspadinë e ka parashtruar për periudhën 18.04.2017-31.08.2021 sa ishte në fuqi kontrata kolektive e vitit 2017, si dhe për periudhën 22.01.2021-31.08.2021 sa ishte në fuqi kontrata kolektive e vitit 2021. Gjykata kishte parasysh edhe pretendimet e tjera mirëpo të njëjtat nuk ndikojnë në vendosjen ndryshe të kësaj çështje

Gjykata vendimin mbi shpenzimet e procedurës kontestimore e mbështeti në nenin 452 të LPK-së, e që e paditura është obliguar që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 125.00 Euro dhe atë në emër të përpilimit të padisë shumë prej 104.00 Euro dhe në emër të taksës gjyqësore për padi shumë prej 21 Euro, ndërsa shuma mbi vlerën e aprovuar për padi, konkretisht shuma prej 104 euro për precizimin e kërkesëpadiës është refuzuar duke u bazuar në Rregulloren për Tarifën e Odës së Avokatëve numri tarifor 6.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë.

Nga sa u tha më lart, e konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 398 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORË NË GJAKOVË- DEGA NË MALISHEVË

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.201/21, dt.28.05.2024

Gj y q t a r j a
Hatixhe Begaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve nga dita e pranimit pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj gjykate.